

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.26.10.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetari i Komunës, drejtorët komunal, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, përf. e KFOR-it, Daut Mjeku, shef i sektorit për ekonomi, Berat Mehmeti, zyrtar ligjor dhe Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cili, pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Dhënia në debat publik e Draft dokumentit për vlerësimin e rrezeqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e Komunës së Obiliqit
4. Dhënia në debat publik e Draft Planit komunal të integritetit për periudhën 2023-2026
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Obiliqit
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale në Komunën e Obiliqit
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit
8. Formimi i Komisionit për shqyrtimin e Ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes të Këshillave lokale
9. Shqyrtimi i kërkesës nga DEFZH-ja, për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2022
10. Raporti nëntë (9) mujor financiar i shpenzimeve për vitin 2022
11. Shqyrtimi i kërkesave
12. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës

Ajet Berisha – Pavarësisht që rendi i ditës është i gjatë, nuk është ky qëllimi pse po kërkoj të hiqet pika 6 e rendit të ditës për shkak se Rregulloren që na keni dërgue nëse, e keni vërejtë është e pamundur me lexue,

asnjë fjalë nuk është e ndarë. Ne nuk po e dijmë se a është duke u bërë për shkak të problemit teknik të konvertimit nga një lloj në llojin tjetër, por 90 % e Rregullores është e palexueshme. Unë jam përpjekë me lexue dhe mi ka marrë 4,5 orë kohë dhe prapë në fund nuk kam mund me kuptue. Arsyeja është kjo, që së paku minimalisht ne me ditë se çka po votojmë.

**Sami Ahmeti** – Pikërisht këtë doja ta thoja edhe unë, por përveç kësaj edhe te pika 4 e rendit të ditës, apo pika 2 e rekomanduar nga KPF-ja, për shkak se Drejtorja e administratës na ka sjellë veç një kërkesë për ta vendosë në debat publik Draft planin komunal të integritetit dhe nuk e kemi materialin përcjellës, nuk e kemi Draftin fare, mendoj se nuk është kurgjë për ngutë me shtye për seancën e ardhshme, që të dijmë se çka po rekomandojmë për debat publik. Neve, nuk na ka ardhë asnjë dokument për me mund me trajtue dhe me pa se cila është baza për me dërgue diçka në debat publik. Nuk është që jemi kundër këtij dokumenti megjithatë, si i tillë nuk ekziston dhe pasi që nuk ekziston nuk kemi çka të rekomandojmë.

**Kryesuesja** – Sa i përket pikës së 4, ne materialin mundemi me ua dërgue posa të përfundoj mbledhja sepse është vetëm për debat publik.

**Enver Gashi** – Deshta të ndërlihem me Rregulloren që përfaqësuesi i LB-së, e potencoi. Të gjitha Rregulloret dhe materiali që vjen prej sekretarisë secili anëtarë i Kuvendit, ne kemi të drejtë që të kërkojmë sqarime. Kjo është një bartje e dokumentit prej një verzioni në tjetrin dhe keni mund me kërkue dhe sigurisht sekretaria kishte me ta dërgue ashtu si duhet që me kuptue secili.

**Ajet Berisha** – Më intereson shefi i grupit të LDK-së, a e ka Rregulloren në mënyrën qysh po thotë të rregulluar dhe nëse, ai e ka unë kërkoj falje vazhdoni mëtutje. Mua, nuk ma merrë mendja as ky që e ka Rregulloren ndryshe përveç qysh e kam unë. Nga ajo që na u ka dërgue neve në email është kjo formë që e kam printue dhe është e pamundur me kuptue. Unë mund të ua ofroj, lexone ose ju nuk e keni marrë mundin me lexue fare, që kjo është diçka tjetër.

**Enver Gashi** – I nderuar, e ke të drejtën me kërkue për vete, ndërsa sa i përket materialit tim a e kuptoj unë apo jo, përgjegjem unë e jo ti. Unë nuk ta përmenda emrin herën e parë, por thashë se nuk ke të drejtë.

**Kryesuesja** – Siç po shihet i kemi 3 propozime: propozimi 1, është rendi i ditës ashtu si ka ardhë, propozimi 2, është të hiqet Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale dhe propozimi 3, të hiqet pika 4 e rendit të ditës dhe po ashtu, edhe Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Ju ftoj të votoni për propozimin e parë për rendin e ditës, ashtu qysh iu ka ardhë.

Pas diskutimeve, me 13 vota për dhe 7 vota kundër miratohet rendi i ditës i cekur më lartë.

#### **Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

#### **Pika 2 e rendit të ditës**

**Ajshe Haliti Pllana** – Unë po ndërhyj te kjo pikë edhe pse nuk ka të bëjë drejtëpërdrejtë me procesverbalin, por ka të bëjë me inçizimin. Nuk është hera e parë që te pika të ndryshme ndalet inçizimi dhe unë kërkoj nga drejtoresha e administratës që derisa ta mbyll kryesuesja mbledhjen të mos ndalet as inçizimi. Pasi që në pikën të ndryshme ne i kemi kërkesat e qytetarëve tonë, drejtuar drejtorëve të caktuar dhe shumica e kërkesave po shkojnë në vesh të shurdhër, unë kisha pasë dëshirë që ai inçizim të shkon dhe secili qytetarë ta din se qysh po e paraqesim ne kërkesën dhe qysh është përgjegjja prej drejtorëve të Drejtorive.

**Lendita Bektashi** – Ne zakonisht e kemi krejtë inçizimin dhe nuk prehet asnjë pjesë e inçizimit, atë mundesh me gjetë edhe te sekretaria e Kuvendit, kështu që nëse, diçka të vyen ne mund ta japim materialin e inçizimit.

**Ajshe Haliti Pllana** – Jo, drejtoreshë mua nuk më duhet, por iu duhet qytetarëve, me i pa kërkesat tona, që ne këtu i paraqesim për drejtorët përndryshe unë mund ta inçizoj veten nëse, kisha pasë dëshirë me pa dhe mua nuk më intereson, por iu intereson qytetarëve me i pa kërkesat e tyre, se ku po shkojnë, a po i paraqesim ne dhe drejtorët sa po merren me ato që ne po kërkojmë prej tyre.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për, 5 vota kundër dhe 2 vota abstenim e miratuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DSHPE-ja, për dhënien në debat publik të Draft dokumentit për vlerësimin e rrezeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për territorin e Komunës së Obiliqit.

**Sami Ahmeti** – Kjo kërkesë që ju e lexuat është kërkesë e muajit shtator dhe kjo është e seancës së kaluar kur është kërkuar që ky Draft të shkoj në debat publik. Kjo është kërkesa që e patëm kontestue me 10, ose 15 gabime drejtëshkrimore. Kjo kërkesë që ju e lexuat kërkon që Draft dokumenti në fjalë të shkoj në debat publik, ndërsa neve sot na ka ardhë me miratue. Sigurisht se është bërë ndonjë gabim.

**Kryesuesja** – Sqaron se këtë Draft dokument e kemi pasë edhe në KPF, që iu rekomandua Kuvendit komunal për dhënien në debat publik.

**Enver Gashi** – Ne jemi që ky Draft dokument të shkoj në debat publik dhe kur të na kthehet atëherë, do ta japim kontributin tonë.

**Sami Ahmeti** – Ne jemi që të shkoj në debat publik, por prapë e them se kërkesën që e lexuat është e dt.21.09, do të thotë e muajit të kaluar, por sido që të jetë jemi për atë që Draft dokumenti të shkoj për debat publik.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft dokumentit për vlerësimin e rrezeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për territorin e Komunës së Obiliqit.

### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Drejtoria e administratës së përgjithshme për dhënien në debat publik të Draft planit komunal të integritetit për periudhën 2023-2026. Drejtoria e administratës do të ua përcjell Projekt planin komunal për integritet në emailat tuaja, që ta keni të gatshëm para debatit publik.

**Enver Gashi** – Ne jemi për dhënien në debat publik të Draft planit, pastaj kur të vjen në Kuvend, do ta japim kontributin tonë.

**Sami Ahmeti** – E thamë edhe në fillim të seancës, derisa nuk kemi dokumente s'kemi çka votojmë. Me dokumente veresi pasi që votojmë ua sjellim, besoj që nuk është dhe nuk ka qenë asnjëherë më përpara diçka e tillë. Sido që të jetë e them prapë nuk është që jemi kundër një dokumenti që është për të mirën e administratës, stafit, apo të kujt do qoftë sepse ky dokument sa e kuptoj unë ngërthen në vete disa Rregullore, qysh është Statuti, LVL-ja dhe Rregullorja e Kuvendit. Megjithatë, jemi kundër në këtë fazë sepse nuk po shohim dokument.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 7 vota kundër e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft planit komunal të integritetit për periudhën 2023-2026.

### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DSHPE-ja, për shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Obiliqit. Në fund drejtori, apo anëtarët e Komisionit munden me dhënë nëse, keni ndonjë vërejtje, apo sugjerim sepse e di se debatet publike janë mbajtur dhe aty kanë qenë pjesëmarrës priftërinjtë, të bashkësisë islame dhe shumë tjerë, të cilët e kanë dhënë kontributin e tyre.

**Enver Gashi** – Ne si grup parlamentar jemi për që kjo Draft Rregullore të kaloj.

**Sami Ahmeti** – Si grup i anëtarëve që unë i përfaqësoj, e thashë edhe në mbledhjen e KPF-së, se ne nuk jemi kundër kësaj Rregulloreje dhe shpresojmë se në përpilimin e kësaj Rregulloreje e kanë dhënë kontributin ata që më së miri i dijnë këto çështje, e që janë ata që ju pikërisht i cekët në fillim të kësaj pike të rendit të ditës. Gjithsesi, shumë herë kemi kërkesa nga qytetarët që nuk kanë hapësira të mjaftueshme për varreza dhe shpresoj që kjo pikë të përfshihet dhe të jetë e specifikuar në këtë Rregullore, edhe pse e kam lexue dhe nuk kam pare diçka të tillë, janë shumë gjërat e përgjithësuara. Mirëpo, ne si grup jemi të gatshëm me dhënë kontributin tonë në këtë drejtim sepse vetëm kjo nuk është politikë por është për të mirën e qytetarëve. Kur po bëhet fjalë për debatet publike, shumë herë ato janë obligim i Ekzekutivit me i mbajtur dhe shumë herë debatet publike po mbahen ashtu siç po mbahen. Edhe pse po ka ftesa, ne ju falenderojmë për ftesat që po na i dërgoni për me marrë pjesë në debate publike. Sido që të jetë duhet të

kuptohet se dora e fundit e çdo dokumenti, ose çdo Rregulloreje jepet nga Kuvendi komunal. Pra, me i lënë hapësirë ashtu qysh thatë edhe ju që Komisioni me i marrë shenimet dhe kur ka diçka që është në favor të qytetarëve, në favor të së përgjithshmes ti merrni ato vërejtje dhe ti përfshini në Rregullore. Ne jemi për nëse, veç nuk ka vërejtje dhe nëse, vërtetë në këtë Rregullore kanë marrë pjesë ata që do të duhej të merrnin pjesë.

**Ajet Berisha** – Unë fillimisht e kam një sugjerim për titullin, zyrtarët mundën me ndihmë, por mendoj se Rregullore për varreza nuk ka kuptim. Brenda titullit përshkruhet prapë se është për ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Pra, sipas mendimit tim kjo Rregullore për varreza nuk ka kuptim, por është dashtë me qenë Rregullore për shërbimet e varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave. Për mua Rregullore për varreza nuk ka një sens logjik dhe është e tepërt këtu, sepse po e përshkruan pjesa tjetër. Ky është një sugjerim që zyrtarët kishin mund me shqyrtue dhe nëse nuk pajtohen me mua, së paku me na dhënë një shpjegim. Më heret kur është propozue me dalë në debat publik, unë e kam dhënë një propozim që në bazë të reagimeve ka pasë përkrahje nga anëtarët e Kuvendit, e që nga Nënkryetari është bërë njëfarë mbështjellimi për pagesën e anëtarësisë për bashkësinë fetare, që me bë Komuna. Nga konsultimet që kemi pasë minimalisht me bashkësinë fetare islame këtu, delë se dikund rreth 50,000-60,000 euro, iu kushton anëtarësia qytetarëve për bashkësinë islame të Obiliqit. Mendoj se kishte me qenë mirë që në kuadër të kësaj Rregulloreje të futet kjo, që Komuna me marrë përsipër këtë pagesë. Kjo, është për 2 arsye, e para ne nuk e dijmë kur na vjen vdekja që po na vjen papritmas, po jemi neglizhentë dhe atje po grumbullohet një sasi e mjeteve, që ka familje të tëra që e kanë vështirësi me bë pagesë të anëtarësisë në momentin kur ndodhë vdekja. E dyta, që është shumë e rëndësishme krerët tonë fetar konsiderohen njerëz me rëndësi dhe me integritet, që në këto situata po bien në pozita shumë të rënda. Te rastet sociale kur vdes personi dhe me vite të tëra nuk ka pague anëtarësi, ai po detyrohet mos me bë varrimin pa e bë pagesën e anëtarësisë. Mendoj se Komuna ka mundësi me këto mjete buxhetore, që herë po na teprojnë, e herë me vullnetin tonë po i drejtojmë ne, nuk është shumë e madhe sepse ligjërisht mund të adaptohet në këtë Rregullore, edhe kjo pikë që unë po e propozoj.

**Kryesuesja** – Komuna veç i mbulon të gjitha shpenzimet tjera të varrimit dhe tani, ftoj drejtorin, apo ndonjëri nga anëtarët e Komisionit të japë sqarime rreth çështjes në fjalë.

**Daut Mjeku** – Ne kemi mundësi si Komunë, ose ligjërisht mund ta përfshijmë në pagesa. Sa i përket titullit Rregullorja për varreza, MAPL-ja e ka bërë një model për të gjitha Rregulloret dhe kështu e kemi përfshi edhe ne në Rregullore. Propozimi i z.Ajet, që të kaloj sipas tij kjo Rregullorer nuk është i keq, por ne kështu e kemi në model Rregullore në përgjithësi, në të gjitha Komunat.

**Sami Ahmeti** – Vetëm për korrektësi dhe për me dalë sa më mirë ky dokument. Te neni 15 dhe 16 përdoret fjala pietet, 2 herë është e shkruar me të kuqe dhe unë mjaft mirë qëndroj me gjuhë, por këtë fjalë nuk e kam gjetë askund, në asnjë gjuhë tjetër, as në gjuhën shqipe. Pyes se çka keni dashtë me thënë “të gjitha varret dhe varrezat do të trajtohen me pietet” jo prioritet.

**Daut Mjeku** – Përgjegjet fjala pietet do të thotë me përkushtim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për dhe 1 votë abstenim e aprovuan Rregulloren për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Obiliqit.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale në Komunën e Obiliqit.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që të aprovohet kjo Draft Rregullore.

**Sami Ahmeti** – U cekë në fillim të kësaj seance që Rregullorja ka qenë e palexueshme dhe nuk ka qenë diçka që kemi mund me lexue. Unë për vete nuk i kam kushtue shumë rëndësi dhe nuk kam mund me lexue, megjithatë jam fokusue te tabelat ku caktojnë çmimoren e dokumenteve të ndryshme që nxjerren. Pashë te tabela 1, numër 15 shkruan vërtetim që personi nuk është banor i Komunës, numër 18, përsëri shkruan vërtetim që personi nuk është banor i Komunës, pastaj numër 23 shkruan një dokument procedurat për trashëgimi. Këtu, as nuk shkruan vendim, as nuk shkruan fillim i procedurave, do të thotë është shumë

joprofesionale dhe nuk mund ta kuptosh se çka do të thotë kjo. Pastaj, ndërrim dhe korrëgjim i emrit personal dhe kjo është përsëritë 3,4 herë në forma të ndryshme si dhe të lëshimi i certifikatës së përdorimit, i çfarë përdorimit dhe kjo nuk ka kurrfarë kuptimi. Te tabela 2,3 shkruan kultivimi i orizit në Obiliq, ishalla kultivohet, shkruan kultivimi i frutave tropikale në Obiliq, shumë mirë. Pastaj, shkruan vetëm si fjalë blegtorja e përzier pa qenë një dokument se çka do të thotë ajo blegtorja e përzier. Po ashtu, shkruan peshkimi detar në Obiliq, do të thotë kishim edhe deti, peshkimi i ujërave të ëmbla e shumë gjëra tjera, që më duket shumë jologjike, ose veç me tregue që është një dokument kopje i marrë prej dikujt dhe mos ta merrë përgjegjësinë Drejtoria se e ka bërë këtë dokument vetë sepse si i tillë unë besoj se nuk i përshtatet Komunës së Obiliqit, mos të merret për keq. Definitivisht mendoj, sepse unë për vete e kam shkollim administratën publike dhe çka do që keni nevojë në këtë drejtim kisha mund me iu ndihmue, se kjo vetëm profesionale nuk është.

**Kryesuesja** – Z.Ahmeti, ka qenë debati publik dhe vërtetë kishte me qenë shumë mirë sikur të kishit marrë pjesë dhe të kishit bashkëpunue me Komisionin.

**Ajet Berisha** – Nuk ka kuptim me kërkue me heqë prej rendit të ditës dhe me dhënë mendim sepse vërtetë ka qenë e pamundur për ata që janë përpjekë me lexue, me kuptue se çka thotë, ka qenë shumë e mundimshme, kështu që ne jemi kundër një materiali që nuk e kuptojmë, as çka thotë.

**Shaip Paloja** – Mendoj se është një Rregullore mjaft e mirë dhe i përfshin tarifat të cilat janë të përbalueshme për qytetarët e Komunës tonë. Unë kam hasë në disa gabime që ndoshta, janë teknike psh neni 7, pika 1.27, ku parashihet ndërrimi i emrit personal me shkronja shkruan çmimi 5 euro, ndërsa me numra është 20 euro. Ky sigurisht se është gabim teknik sepse është përfshi korrëgjimi i emrit dhe ndërrimi i emrit personal. Te anulimi i martesës, sigurisht bëhet fjalë për shkurorëzim sepse anulim dhe shkurorëzim janë 2 gjëra të ndryshme. Mendoj se aty ku shkruan anulim i martesës, duhet të jetë shkurorëzim dhe është tarifa e caktuar sepse anulimi i martesës mund të bëhet edhe para shkurorëzimit. Te kurorëzimet kur jemi, unë nuk e di se a ka bazë ligjore për kurorëzimet e të rinjëve që bëhen në objektin e gjendjes civile, që ishte çmimi 10 euro, unë e kisha heqë fare. Të gjithë të rinjëve që kurorëzohen brenda objektit dhe brenda orarit çmimin prej 10 euro e kisha heqë krejtë.

**Daut Mjeku** – Më vjen keq që Rregullorja nuk ka shkue ashtu qysh duhet në programin word, apo exell dhe unë dua të ju shpjegoj shkurtë qysh është punue Rregullorja. Bazuar në LVL-në, Ligjin për financa, Rregullorja është hartuar sipas standardeve të ligjeve, të Urdhëresave administrative, modelit të Rregullores nga Asociacioni i Komunave, të cilat e kanë marrë përsipër që çdo punë që bëhet në Komunë MAPL-ja, të bëjë një model Rregullore. Ne kemi punuar edhe me Komisionin, por gjithmonë duke pasë si model Rregulloren e cila është lëshue prej Asociacionit të Komunave. Siç dihet buxheti komunal hartohet prej të hyrave vetanake, që na u ka dashtë me punue në këtë Rregullore, sepse kemi të hyra vetanake të cilat caktohen nga Ministritë përkatëse, të cilat pastaj me KAB duhet të përmbushet plani i financave në Komunë. Po ashtu, janë edhe grandet nga Qeveria dhe donacionet tjera. Kjo Rregullore është punuar që të krijoj bazë të të hyrave komunale. Tarifat janë ndarë nëpër të gjitha Drejtoritë, ndërsa DEFZH-ja është baza e cila e përcjellë dinamikën e këtyre të hyrave. Të hyravt vetanake, janë të gjitha shumat e parave publike të cilat janë shqiptuar dhe janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga Komuna. Për taksa dhe tarifa kemi shkue duke u bazuar në shpenzimet e fuqisë punëtore, kohën e punës dhe materialin e shpenzuar për ato. Gjendja civile është e njejtë për gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe z.Shaip Paloja kur foli për të hyrat 10 euro, do të thotë aty shkohet në bazë të fuqisë punëtore, kohës së punës dhe materialit shpenzues. Psh një dokument për një

certifikatë të lindjes është 1 euro, ndërsa për 1 dokument që duhet më shumë punë, material shpenzues, fuqi punëtore siç është kurorëzimi çmimi është 10 euro. Sa i përket të hyrave tjera që i kemi të Agjensionit kadastral, të gjendjes civile, të urbanizimit, është fakt që ne kemi shkue jokopje, por model sepse Agjensioni kadastral i ka të hyrat e veta dhe ne vetëm i përshkruajmë. Unë e kam një vërejtje se para 2 dite e kam marrë Udhëzimin administrativ prej Ministrisë së industrisë, ndërmarrësisë dhe tregtisë ku taksat për regjistrim ndryshim të bizneseve janë ndryshue dhe ne duhet ta aprovojme këtë ndryshim. Po ashtu, janë disa gabime

që i potencoi z.Ahmeti , psh vërtetim që nuk është banor i Komunës është 1 euro, por vërtetim që personi nuk është i regjistruar në regjistrin civil është 1 euro. Psh e kemi me rend te vërtetimet tjera, të cilat dallojnë me një fjali të vetme dhe teksti mendohet se është i njejtë, por e ka një fjali.

**Sami Ahmeti** – 15 dhe 18 nuk ndryshojnë asnjë shkronjë.

**Daut Mjeku** – Sqaron se 16 është vërtetim mbi konfirmimin e identitetit, 18 është vërtetim që personi nuk është banor i Komunës. Është edhe një çështje kur është puna te orizi, kripa e biberi ne kemi shkuar me shifrat e veprimtarive në biznes dhe nuk kemi dalë me dhënë asnjë shifër. Gabimet mund të jenë teknike, por ne nuk e lëshojmë Rregulloren pa e përmirësuar edhe njëherë.

**Kryesuesja** – Pra, mbetet nga ana e Komisionit ti përmirësoj këto gabime dhe të merren parasysh vërejtjet dhe sugjerimet të cilat u dhanë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për, 5 vota kundër dhe me 2 vota abstenim e aprovuan Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale në Komunën e Obiliqit.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DMM-ja, për shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që kjo Draft Rregullore të shkojë ashtu qysh është pasi i ka kryer të gjitha debatet publike.

**Sami Ahmeti** – Mirë që do të vazhdohet me çmimorën e njejtë sepse kjo ka qenë edhe kërkesa kur ka ardhë fillimisht në seancat e kaluara kjo Draft Rregullore. Te neni 6, pika 9 që shkruan përcaktimi i orarit dhe dinamikës së mbledhjes së mbeturinave në marrëveshje me operatorin, ne propozojmë që të shkohet përcaktimi dhe publikimi i orareve. Këtë e them për faktin se shumë herë në shumë rrugë kaqerë qëndrojnë me orë të tëra, ose gjatë gjithë ditës, edhe natën mbeturinat shpërndahen prej qenve endacakë. Të vendoset një orar dhe të publikohet, që ta dijë secila lagje se kur do të mbledhen mbeturinat. Besoj është një diçka e vogël që mund të bëhet në një qfaqje përmes ndonjë platforme online, Pastaj, te neni 6, të shtohet një pikë ku thuhet vendosja e kontejnerëve për mbeturina inerte në të gjitha vendbanimet. E pashe që e keni cekë në Rregullore që mbledhja e këtyre lloj mbeturinash do të bëhet 2 herë në vit, por besoj se është e pamjaftueshme për qytetarët. Te neni 8, pika 1 ku thuhet çdo gjenerues i mbeturinave, ka të drejtë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, ne mendojmë se duhet të ndryshohet në “çdo gjenerues i mbeturinave obligohet të kyqet në shërbim të grumbullimit të mbeturinave”. Kjo, për arsye se pikërisht këta gjenerues të mbeturinave, ose banorë po shkaktojnë ndotje gjithë andej. E thashë se jemi për të vazhduar me çmimore të njejtë dhe pikërisht për këtë e them se çmimi 4 euro e 65 centë, është aq minimal sa që është gati gratis dhe secila familje ka mundësi të paguaj këtë

çmim. Në rast se Komisioni që është marrë me përpilimin e kësaj Rregulloreje shprehë vullnet për këto ndryshime, ne jemi të gatshëm të ua dërgojmë edhe në formën online këto,

çdo kontribut që është e mundshme. Unë e thashë më heret nuk do të thotë se është mbajtur një debat publik dhe propozimet e Kuvendit, nuk duhet të merren parasysh dhe nëse, veç nuk duhet me u marrë parasysh atëherë, nuk kemi se çka të diskutojmë, vetëm hudhet në votim.

**Kryesuesja** – Jo, z.Ahmeti, në Rregulloren paraprake që e votuam propozimet tua u morën.

**Ajet Berisha** – Unë të vetmin dyshim në çmimore e kam se të gjitha analizat kanë dalë se çmimi është tepër i ulët. Unë konsideroj shpeshherë kundër gjendjes së rëndë që e kemi te popullata dhe si familje në përgjithësi çmimi po e dedikon edhe cilësinë. Prandaj, meqë është çmimi i ulët edhe cilësia e shërbimit është e ulët sepse kapacitetet janë të kufizuara, që ose duhet me kërkue subvencione, ose s'mund ta mbajë vetveten për me realizue një punë më korrekte. Unë para 3,4 viteve e kam hasë një çmim real 10.80 ka qenë për amvisni, do të thotë kështu është analizue. Në rast se ne e detyrojmë kompaninë me punue me këtë çmim të ulët, është mirë me marrë edhe zotimin me thënë se ne do të dalim në mbështetje meqë, ti nuk mundesh, për hir të nivelit të ngritjes së kapaciteteve dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve që kryhen. Kjo, është një dilemë e imja që shpeshherë është në luhatje. E dyta, përfshirja e shumë familjeve është me shumë



interes në këtë drejtim, edhe listimi të nenit 12, thotë dispozitat ndëshkuese dhe gjobat, lista e ndëshkimeve, që mendoj se në bazë të ligjeve kishte me qenë mirë që në këtë Rregullore me i pa. Ato ndëshkime, në bazë të Rregullores që i marrum në për secilin që vepron në kundërshtim me Rregulloren duhet me i pa edhe qytetarët, me i publiku dhe në njëfarë forme me ditë që kanë një obligim ata, me ruajtë mjedisin, me i respektue rregullat e hudhjes së mbeturinave, e ndarjes së tyre etj. Pra, kishte me qenë mirë që atë listë, atë çmimore të gjobave me futë në kuadër të kësaj Rregulloreje. Te pika 3 e nenit 12, mendoj se është kohë tepër e gjatë në rast se ti 2 vjet e toleron dikend mos me pague atëherë, të tjerët kanë me marrë shembull të keq. Pra, nuk ka 2,3 muaj viti bile është gjatë dikush nëse, nuk e paguan këtë shërbim, pse me ia krye punën. Për këtë mendoj se si pasojë e këtyre veprimeve po na vjen gjithë kjo ndotje mjedisore dhe e mungesës së zbatimit të Rregullores.

**Kryesuesja** – Unë nuk besoj që kompania e lejon dikend aq gjatë, por me siguri janë bazuar dikund. Këtu, e kemi Kryetarin e Komisionit z.Berat Mehmeti, që e di se keni pasë takime të shumta me kompaninë, përveç juve edhe aksionarët që janë kanë mbajtur takime, a pajtoheni me këto sugjerime që u dhanë.

**Berat Mehmeti** – Nëse, anëtarët e Kuvendit vendosin që këto propozime të kalojnë, atëherë ne nuk jemi kundër.

**Labint Mirena** – Te çështja e mbeturinave, unë kam qenë kundër të çmimi dhe e kam arsyetu pse jam kundër. Mirëpo, pasi jemi në regjion me këtë çmim aksionarët kryesor në këtë rast Komunitat kanë mbetur brenda këtyre 2,3 muajve me u takue të gjithë dhe me bë një ndryshim të çmimore së regjionit, e jo me shkue vetëm ne si Obiliq, psh me dallue prej Fushë Kosovës, ose prej Prishtinës sepse jemi në regjion me ata. Kjo, është arsyeja që unë jam në rregullë me vazhdue me këtë çmim derisa të merret një vendim prej aksionarëve kryesor. Pajtohem me z.Ajet, që me ua bë obligative, që krejtë me qenë në shërbim të mbeturinave, të gjitha deponitë ilegale që çdo vit ne japim mjete me i heqë Komuna, bëhen mbeturina prej atyre që nuk janë kyqë në shërbime të mbeturinave. Koha 2 vjet për procedura përmbartimore është e gjatë sepse 2 vjet për amvisni bëhen 120 euro borxh, që pastaj nuk ka mundësi me i pague. Është mirë që kur të bëhet ndryshimi në çmimore rasteve sociale ne si Komunë mundemi me ua falë krejtë, ose të paguaj Komuna për rastet sociale. Z.Sami, te çështja e çmimit dhe te shërbimi është 4.70 me këto çmime të derivateve, që është e pamjaftueshme kostoja veç e operimit. Ne e kemi makinerinë e madhe, por shpenzimet për neve janë të pamjaftueshme dhe unë po flas në cilësi të kompanisë ku jam.

**Fidan Ahmeti** – Unë jam pjesë e Bordit të aksionarëve në kompaninë “Pastrimi” dhe ne kemi mbajtur mbledhje, por nuk kemi marrë vendime për rritjen e tarifave, pasi që duhet me u bë për të gjitha Komunitat që jemi. Unë pajtohem me z.Ajet, që tha se duhet të rritet tarifa, por në të njëjtën kohë edhe cilësia, do të thotë se ne edhe një arsye më pak e kemi mos me qenë higjiena në nivel në Komunën tonë sepse gati i kemi 2 kompani që operojnë. Mos të them se ndoshta, duhet të jemi njëra prej Komunave më të pastërta, edhe pse është, mund të jetë edhe më shumë pasi që i kemi 2 kompani. Shpresojmë të rritet tarifa dhe të rritet më shumë cilësia.

**Sami Ahmetii** – Unë e kuptoj realitetin që është rritja e çmimit të naftës e shumë gjërave tjera, përcjellëse dhe fakti që thashë se jam për me vazhdue me këtë çmim nuk është se jam injorant dhe që dua me i shkaktue dëm kompanisë sepse secila kompani, ose institucion funksionon me njëfarë lloj profiti të vet. E mbuloj këtë kërkesën time me arsyetimin që e thashë qysh në fillim që të obligohen, të futen në sistem të mbledhjes së mbeturinave të gjitha familjet. Në lagjen time psh mbeturinat i gjuajnë 4,5 shtëpi, ndërsa 7,8 tjera nuk i gjuajnë fare, do të thotë nafta e njejtë kalon andej kur kalon. Në rast se ne i obligojmë familjet dhe mundesh me i obligue me listë kush ka orë elektrike, kush jeton aty ai gjeneron mbeturina dhe nëse, nuk i vendos mbeturinat në shportën e vet i vendos në shporta dikund, ose i gjuan gjithandej. Ne kemi shumë fshatra dhe lagje që nuk janë të përfshira në sistem të mbledhjes së mbeturinave dhe kur kamioni shkon në atë rrugë nuk shpenzon kurgjë ekstra, mirëpo hyjnë në sistem të mbeturinave të gjithë qytetarët, rritet profiti i kompanisë dhe rritet mirëmbajtja e ambientit. Ky ishte qëllimi im sepse prapë jam nëse, veç nuk ka mundësi me funksionue, normal që një diçka që blehet me një çmim shumë më të lartë nuk mundet me u shitë më lirë.

Edhe ne e kuptojmë se është shtrenjtu nafta, por kjo është masa e parë që mendoj shumë se do ti sjellë profit edhe kompanisë edhe ambientit.

**Fidan Ahmeti** – Unë kisha me shtue te kontejnerët që janë shumë psh te kisha në mëngjez kam ankesa prej qytetarëve, sidomos të asaj lagjeje aty se vijnë prej fshatrave tjerë, si prej Komunës së Vushtrrisë dhe Komunave tjera, në ora 7 të mëngjezit dhe i gjuajnë mbeturinat me vend, ose pa vend, me thasë që nuk janë të kësaj Komune hiç në rend të parë. Unë kisha me kërkue prej Drejtorisë së inspektoriatit me bë një kontroll në kohën e mëngjezit, që të gjendet një modul në mënyrë që të ndalohen këto dukuri negative që janë duke ndodhë. Edhe për rastet sociale, edhe unë pajtohem që të lirohen sepse mjaft ka biznese, që mund të paguajnë.

**Kryesuesja** – Ju lus që propozimet, sugjerimet që u dhanë ti dërgoni me shkrim në email në mënyrë që Komisioni ti bëjë këto ndryshime dhe plotësime në Rregullore.

**Enver Gashi** – Nuk ka plotësim, verzioni i Rregullores është dhe Rregullorja votohet tash. Ju lus ta hudhni në votim, të votojmë për, ose kundër.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e aprovuan Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DAP-ja, për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes të Këshillave lokale.

**Sami Ahmeti** – Lidhur me këtë pikë pasi të bëhen propozimet kisha dashtë me pa një fakt që po duket se ky Komision që e thashë edhe në mbledhjen e KPF-së, është duke u formuar në kohën jashtëligjore. Duke u bazuar në Rregulloren që e kemi miratuar, në të cilën Rregullore kam dhënë pak kontribut dhe jemi dakordue që me i bë disa ndryshime, gjithçka është shkue sipas asaj qysh e kemi mendue. Megjithatë, te Komisioni i ankesave thuhet se ankesat për parregullësi në procesin zgjedhor mund të paraqiten brenda 3 ditëve të punës. Deri më tani janë zgjedhë 7 Këshilla lokale dhe këto Këshilla lokale të zgjedhura, deri më tani nuk e kanë pasë mundësinë e ankesave sepse ka kaluar mundësia 3 ditore. Sot kur i kemi vetëm edhe 3 fshatra, është sot, nesër dhe pasnesër, Tani, kur i kemi në përfundim këto Këshilla të fshatrave po formohet një Komision, i cili edhe kështu e merrë një procedurë derisa të bëhet miratimi i tij, apo qysh shkon procedura në MAPL. Mendoj se krejtë kjo punë që është bërë brenda një muaji ka me ra poshtë për shkak se qytetarët e zgjedhur në Këshillat e fshatrave, sipas Rregullores, që këtu e kemi miratue nuk e kanë pasë një mundësi që është bazike, mundësia e ankesave. Në kohën kur është zgjedhë Komisioni, ka qenë dashur të zgjedhet edhe Komisioni për ankesa dhe më vjen shumë keq për gjithë këtë punë që është bërë. Unë vetë do ti shkruaj MAPL-së, sepse nuk do të lejoj që të shkelet një nen ku edhe ne kemi dhënë kontribut.

**Lendita Bekteshi** – Dua ta njoftoj z.Ahmeti, se ne ende nuk e kemi bërë shpalljen e kandidatëve që i kemi zgjedhë për Këshillin e fshatrave lokale. Ne nuk jemi vonë me këtë Komision për shkak se ende jemi në procedurë, prandaj Komisioni i ankesave ka kohë të mjaftueshme për punën e vet. Unë nuk besoj se kemi bërë ndonjë shkelje sepse nuk kemi mund me thirrë seancë të jashtëzakonshme për me formue këtë Komision.

**Enver Gashi** – Propozon znj.Nazlije Shala, për anëtare të Komisionit.

**Valon Svirca** – Propozon z.Sami Ahmeti, për anëtar të Komisionit..

**Biljana Spasic** - Propozon z.Ratomir Ristic, për anëtar të Komisionit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për e aprovuan Vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes të Këshillave të fshatrave.

#### **Pika 9 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2022. Edhe në mbledhjen e KPF-së, e kemi shqyrtue ku drejtoresha ka sqarue se për shkaqe familjare ka harruar ta përfshij, apo iu është fshi nga programi edhe pika 6, e cila sqaron se ku duhet të barten mjetet.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që të kaloj kjo kërkesë.

**Sami Ahmeti** – Në rregullë është, le të shkoj për votim.



**Ajet Berisha** – Përveç pikës 6, që nuk po e dijmë se çka është, në rast se drejtoresha e ka shpjeguar në KPF, duhet edhe para anëtarëve të Kuvendit me shpjeguar.

**Zarife Behluli** – Nuk do të thotë se çdo njeri nuk mundet me lëshuar një gabim. Edhe kryesuesja e ceku se e kam pasë një rast në familje, kam pasë shumë ngarkesa dhe më ka shpëtuar një gabim i tillë. Pika 6, është rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit në vlerën prej 26,924.67. Unë në mbledhjen e KPF-së, e vërejtja vet këtë gabim, ua sqarova dhe kërkesën menjëherë e kam bërë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 21 vota për e aprovuan Vendimin për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2022.

#### **Pika 10 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti raportin nëntë (9) mujor financiar të shpenzimeve për vitin 2022.

**Sami Ahmeti** – Njëjtë sikurse raportet e kaluara shumë i përgjithësuar dhe pse duhet të fshehen projektet nga anëtarët e Kuvendit, pse po na detyroni që për çdo gjë të iu bëjmë kërkesë me email. Para se të thoni se forma e raportimit është e tillë, dua të them se e kuptojmë formën e raportimit, por edhe të drejtën tonë si anëtarë të Kuvendit komunal, për të ditur, për të patur qasje në informacione për secilin projekt. Te kategoria mallra dhe shërbime për arsimin fillor për këtë periudhë kohore janë alokuar gjithsesjtë 100,000 euro, janë shpenzuar vetëm 58,337 euro, ose 58 % e mjeteve të alokuara kur dihet se shkollat në Komunën e Obiliqit, përballen me shumë mungesa. Shkollat tona nuk kanë tabela siç duhet, ende punojnë me shkumësia si para një shekulli, nuk kanë kabinete të gjuhëve, nuk kanë as letër në shkolla. Shpesh kërkojnë mjete nga prindërit për të vendosur perde, apo për të fotokopjuar materiale. Vetë kam qenë dëshmitar në një shkollë ku kujdestarja e klasës kërkonte edhe letër për printer. E tillë besoj se do të jetë gjendja edhe në arsimin e mesëm ku nga 25,000 euro, të alokuara janë shpenzuar vetëm 3,000 euro, ose 12 %. Te kategoria e subvencioneve dhe transfereve përveç që keni ndarë pak mjete për subvencionimin e bujqësisë në gjithë vitin fiskal për këta 9 muaj, keni të alokuara 177,394 euro, keni shpenzuar vetëm 55,171 euro, apo vetëm 31 % të tyre. Të gjithë e dijmë se ky vit nuk është vit fushate, por bujqit e meritojnë ndihmën e institucioneve, aq më tepër në këtë kohë krize globale. Me ritmin e punës tuaj i bie që për këtë vit subvencionet e bujqësisë të mbeten vetëm në letër. Pak jashtë teme, por kjo ka të bëjë me bujqësinë, pse në këtë vit Komuna jonë nuk ka ndarë subvencione për farëra edhe pse ke një premtim fushate në zgjedhje. Te investimet kapitale në këtë kategori bie në sy që mjetet e alokuara për disa projekte nuk janë shpenzuar. Për ndriçim publik 50,000 euro, për ndërtime dhe mirëmbajtje të stacioneve 10,000 euro, për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve 40,000 euro, për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 30,000 euro, për digjitalizimin e rrugëve dhe objekteve publike 200,000 euro, dhe për ndërtimin e sheshit 200,000 euro. Bëhet fjalë gjithsejtë për 630,000 euro të alokuara për këta muaj për investime, por që nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Pyes, a mund të na njoftoni se në çfarë faze është puna për këto projekte momentalisht. Edhe zgjerimi i sheshit në formën e proklamuar nga ju, vetëm sa do të ua zë frymën bizneseve të cilat edhe ashtu mezi po mbijetojnë. Ka qenë e rrugës me kohë të bëhet rialokimi i këtyre mjeteve dhe të shfrytëzoheshin në punë të mira, në të mirë të qytetarëve. Nga 2 milionë euro, të alokuara te kogjenerimi janë shpenzuar vetëm 79,548 euro, gjë që tregon se ky projekt po ecën me ritëm shumë të ngadaltë. Ju lutem na njoftoni se cilat janë shkaqet, pse po na neglizhohet ky projekt, që është aq i rëndësishëm për qytetarët.

**Ajet Berisha** – Është një përmirësim në shpenzim edhe pse shumë i vogël do të thotë për 19 %, është rritë shpenzimi te investimet kapitale. Unë nuk dua të hyj te realizimi i të hyrave vetanake, është i mirë dhe është tejkalue për çka votuam ne për edhe mbi 200,000 euro më tepër, që shihet një angazhim në këtë drejtim. Mirëpo, shqetësimi im është te mungesa e transparencës në shpenzim, e sidomos te investimet kapitale, që vetëm 25 % e mjeteve të planifikuara deri më tash janë shpenzuar, edhe ato në shpenzime na i paraqitni në mënyrë shumë të përgjithësuar. Është kohë e digjitalizimit, por 44,000 euro, pajisje kompjuterike nuk e di vetëm nëse ua keni dërguar shkollave se neve llap topët nuk na i keni sjellë, që ka mund me kushtuar edhe ajo diçka. Në thelb është një shpenzim kogja i madh që ndoshta është dashtë njëfarë shpjegimi me u dhënë. Pastaj, e kemi ndërtimi i objekteve dhe renovimi i hapësirave për komunitete, dikund janë 430,000 euro të

parapara ndërsa, të shpenzuara 176,000, që kisha dashtë me ditë çka u ndërtue dhe ku është renovue në këtë drejtim. Te rregullimi i kanalizimit në Obiliq, sinqerisht nganjëherë kur rregullohet kanalizimi ne e shohim se priset asfalti dhe në bazë të kësaj e kam përceptimin se ky shpenzim 136,000 euro, është mjaft i madh dhe kurrë nuk kam pa pajisje duke u prishë para asfaltit, jo që kam informatë. Te bashkëfinancimi kanë shkue 30,013 euro, me sa më kujtohet mua nga një seancë e kaluar ne 300,000 euro, që i kemi pasë për kogjenerim i kemi gjuajtë te bashkëfinancimi. Nëse, edhe këtu 270,000 kanë qenë do të thotë 570,000 është dashtë si grumbull i mjeteve me qenë te bashkëfinancimi dhe me u shpenzue 30,000 euro, nuk po e di arsyen. Unë po kërkoj përgjegje sepse mund të jetë edhe komplet e arsyeshme. Shumë elemente nga ky raport janë që ne nuk mundemi me kuptue saktë e para shpenzimi i vogël, e dyta është lloji i shpenzimit sepse nuk po mund ta vërej në terren këtë aktivitet, edhe ky i pakët që është nuk është që po vërehet në terren.

**Zarife Behluli** – Sqaron se këtu, janë të cekura 5 kategoritë ekonomike: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere edhe investime kapitale. Të gjitha këto që u cekën më lartë kanë qenë në procedura të Prokurimit dhe në disa projekte ka pasë ankesa. Këto, veç janë finalizue në Prokurim dhe vetëm priten punët me u ekzekutue. Te bashkëfinancimi që u cekë, ne po flasim deri me dt.30 shator 2022. Nëse, doni unë edhe një raport të posaqëm ua dërgoj për tetor. Këto, veç janë mjetet e alokuara, por deri të nënshkruhet vendimi nga ministri i financave, unë nuk kam mund me raportue me thënë se janë edhe kaq mjete që i kemi marrë. Është e vërtetë se ne në mbledhjen e kaluar i kemi marrë 150,000 euro, prej disa projekteve dhe i kemi alokue te vija e bashkëfinancimit dhe ato mjete ne tash i kemi zotue, vetëm pritet punimet me u krye dhe me u bë shpenzimi.

#### **Pika 11 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës, për ndryshim plotësimin e vendimit nr.-I-126, të dt.27.09.2022, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), duke zëvendësuar anëtarin nr.6, z.Avdyl Mustafa me z.Faton Beka.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për dhe 6 vota abstenim e aprovuan Vendimin për ndryshim plotësimin e vendimit nr.-I-126, të dt.27.09.2022, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), duke zëvendësuar anëtarin nr.6, z.Avdyl Mustafa me z.Faton Beka.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Kryetari i Komunës, për shfuqizim të vendimit nr.-I-47, të dt.23.03.2021, për personat e prekur me covid 19.

**Enver Gashi** – Ne konsiderojmë se ky vendim duhet të shfuqizohet me vetë faktin se që 3 javë nuk kemi asnjë rast, që mendoj se ne si Komunë dhe si Kuvend komunal e kemi dhënë kontributin tonë gjatë pandemisë. Tash, është koha të ndërprehet ky subvencionim.

**Sami Ahmeti** – Vetë fakti që nuk ka për momentin pacientë, ose të sëmurë me këtë virus, nuk do të thotë se nuk do të ketë në muajt në vijim sepse tash veç po hyjmë në muajt e dimrit. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) nuk e ka shpallë si të mbyllur këtë virus dhe ende është rrezik potencial për qytetarët. Në rast se ky vendim qëndron aktiv dhe nuk ka të sëmurë, do të thotë nuk shpenzohet asnjë centë. Ne mendojmë se është mirë të vazhdohet sepse mund të ketë prapë të infektuar, mund edhe të vdesin prej këtij virusi sepse e thashë në fillim se nuk është i shpallur si i mbyllur, por është i shpallur se nuk ka më rrezik potencial, qëndron aktiv. Ne jemi kundër që ky vendim të shfuqizohet.

**Ajet Berisha** – Mendoj se para se të shfuqizohet janë disa paralajmërime jo aq të mira, sidomos nga Gjermania, që është një alarm atje dhe një infektim masiv, një ndryshim i këtij virusi. Do të thotë ka potencial ende sidomos te ne për shkak të numrit të madh të njerëzve, familjarëve tonë që i kemi në Gjermani me u bartë dhe me ardhë këtu. Unë kisha me thënë jo me shfuqizu vendimin, por me ndryshue te kategoritë sociale që të mbeten, të ndihmohen në rast se atakohen nga ky virus, e jo pjesa tjetër që nuk kanë mundësi me dëshmue se i takojnë kësaj kategorie.

**Shaip Paloja** – Ne të gjithë e dijmë se Komuna e Obiliqit ka qenë e para që ka fillue me subvencionim të personave të prekur me covid, bile nëse nuk është e para, e dyta jam i sigurtë. Në atë kohë kjo ndihmë ka qenë e mirëseardhur për banorët e Komunës së Obiliqit sepse pandemia ka prekë jo vetëm Komunën tonë,

por ka qenë në nivelin global në tërë botën. Tash, kur kemi parasysh se covid është përsëritë te disa persona edhe 2, 3 herë, ku të gjithë kanë përfitue dhe ne e dijmë se ajo është një kosto bukur e madhe për Komunën. Unë nuk po them se jam kundër me iu ndihmue, por ne jemi të njejtit njerëz nëse, paraqitet nevoja do të votojmë prapë, ndoshta një vendim më të mirë, më të favorshëm për qytetarët e Obiliqit. Unë jam për atë që ky vendim të shfuqizohet.

**Kryesuesja** – Edhe unë kisha një mendim të tillë dhe urojmë që mos të ketë raste prapë, por në rast se vjen një gjendje alarmante ne pa telashe e nxjerrim një vendim me specifikacione pak më të hollësishme.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 7 vota kundër e aprovuan Shfuqizimin e vendimit nr.-47, të dt.23.03.2021, i plotësuar sipas vendimit nr.-I-350, të dt.11.12.2020, për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, për përkrahjen e banorëve të prekur me covid 19, të Komuns së Obiliqit.

**Kryesuesja** – Ju njoftoj se z.Jeton Mjekiqi, i cili ka qenë anëtar i Komisionit në NPL “Kastrioti” ka dhënë dorëheqje dhe tash duhet të ndryshohet e plotësohet vendimi nr.-I-4, të dt.24.12.2021.

**Enver Gashi** – Propozon z.Bajram Hashani, për anëtar të Komisionit.

**Sami Ahmeti** – Ne nuk kemi propozim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për, 4 vota kundër dhe 1 votë abstenim e aprovuan Plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-4 të dt.24.12.2021, për formimin e Komisionit të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Kastrioti” SH.A. duke zëvendësuar anëtarin z.Jeton Mjekiqi me z.Bajram Hashani.

**Kryesuesja** – Ju njoftoj se kërkesën e Naser Sollovës e kemi shqyrtuar në KPF dhe e kemi adresue në DSHPE. Nga drejtori i DSHPE-së, kemi një përgjegje për këtë kërkesë lidhur me parkingun se deri më tani është shfrytëzuar parkingu i shkollës. Mirëpo, për të rritur sigurinë rreth objektit shkollor dhe mobilitetit të asaj zone parkingu i shkollës është ndaluar për përdorim të banorëve të zonës dhe bizneseve përreth. Komuna siç e dini është duke ridizajnuar qendrën e qytetit, duke zgjeruar sheshin dhe njëkohësisht duke krijuar zona të reja parkingu, siç është rasti i ndërtimit të 2 parkingjeve në qendër të qytetit, të cilat janë të shfrytëzueshme edhe për banorët e ndërtesave përreth. Konkretisht për mundësinë e hapësirave të reja për parking duke u bazuar në kërkesën e banorëve, do të bëjmë një analizë konkrete dhe do ti njoftojmë banorët e ndërtesave A1 dhe A2.

**Ajet Berisha** – Unë i takoj asaj pjese që kanë bërë kërkesë dhe mendoj se drejtori ka të drejtë në aspektin logjik dhe praktik të sigurisë së shkollës. Shkolla ka oborr të mjaftueshëm dhe jodomosodoshmërisht është dashur oborri i shkollës me qenë deri aty, jo për ndonjë arsye tjetër vetëm se edhe parkingjet, qytetarët dhe veturat e tyre janë brengë e kësaj Komune. Ne ku kemi me i lënë veturat, në podrume nuk futen ato, do të thotë mbyllja e atij parkingu ka shkaktue problem të jashtëzakonshëm për banorët e asaj lagjeje. Mendoj se drejtori është dashtë urgjentë atë laurën me vendos në brendësi me i lënë derisa të bëhet zgjidhje për këta qytetarë sepse ne nuk mund ti lejmë veturat në Bakshi dhe me ardhë me jetue në Obiliq. Krejtë këto janë aspekte praktike që drejtori duhet me i pasë parasysh kur e jepë përgjegjen. Unë e di se janë bërë disa parkingje dhe është shumë mirë, por duhet ende të bëhen sepse janë të pamjaftueshme. Mirëpo, derisa të bëhet një i ri që përafërsisht kishte me i mbulue kërkesat e qytetarëve të zonës, mendoj se nuk është dashtë me u mbyllë. Kjo laurë është dashtë të vendoset në pjesën e brendshme dhe këtë parking me llogarit që nuk është pjesë e oborrit të shkollës sepse edhe kjo lagje dhe parkingjet janë obligim i kësaj Komune, i këtij drejtori.

**Kryesuesja** – Drejtori është mirë ti ftoj njerëzit që kanë nënshkrue dhe kanë telashe të tillë që me u kordinue dhe me gjetë një zgjidhje sa më shpejtë. Ne e kemi kërkesën nga Naim Grajqevci, Kryetar i sindikatës së administratës komunale, i cili ka kërkuar të ndahen 500 euro për të gjithë të punësuarit në administratën e Komunës së Obiliqit për vitin 2022, si pako ushqimore. Ne këtë kërkesë e kemi adresue në DEFZH dhe kërkojmë me shkrim në mbledhjen e radhës nëse, ka mjete, që të bëhet një zgjidhje.

**Pika 12 e rendit të ditës**

**Ajet Berisha** – Unë kam një kërkesë për Drejtorinë e Arsimit dhe investuesin e sallës së sportit në shkollën e Mazgitit. Unë i gëzohem secilit investim, por vërtetë është për keqardhje vendi ku është vendosë me u ndërtue kjo sallë e sportit. Unë kisha kërkuar nga investitori, në këtë rast nga Komuna jonë, e sidomos nga Drejtoria e Arsimit urgjentisht të ndajë sa nuk kanë bërë investime më tepër dhe të gjejë një pozicion tjetër ku mund të vendoset kjo sallë. Vërtetë e ka bllokue shkollën total, ose e keni në plan me zhvendosë shkollën pastaj me bë një shkollë tjetër. Unë ju lus shkoni shihne ata që nuk e kanë parë dhe në vetvete keni me kuptue se nganjëherë me investimet tona po shkaktojmë më shumë pengesa se sa që po bëjmë hajr diçka. Është lutje shumë e sinqertë, që kjo mos të vazhdoj në atë pozicion dhe të ndryshohet lokacioni.

**Sahit Zeqiri** – Vërtetë, kur flasim për Arsimin, është fushë shumë dimensionale që ndoshta nuk kishte me mjaftue vetëm kjo pikë që sot e paraqiti z.Ajet, sepse shkollat tona gjithkund që janë në nivel të Kosovës, kemi nevojë të trajtohen në mënyrën më të sinqertë. Kërkesa e z.Ajet, vërtetë është kërkesë me vend, por ne kur kemi dalë në vend që të caktojmë pozicionin se ku do të jetë ajo sallë sportive, e kemi shikue se e ka një vend jo të përshtatshëm aty tani ku është. Mirëpo, pengesë kryesore është vendosja e një gypi, që nuk i di dimensionet e tij, por e furnizon Kosovën A me ujë dhe krejtësisht ajo pjesë është në një vijë të trekëndëshit në diagonale. Ne jemi konultue edhe me disa anëtarë të Bordit të KEK-ut, të cilët thojnë se nuk lejojnë që ajo pikë të zhvendoset në një pozicion tjetër.

**Valon Svirca** – Aty, unë e di ku është gypi i Ibër-Lepencit, psh ajo pjesa poshtë andej që ne i themi nga Sollovët, ka vend të mjaftueshëm dhe sa e di unë nuk ka gyp, as nuk ka asgjë. Është pjesa këndeje përpara rrugës, e prekë shkollën dhe banjot jashtë që kanë qenë, aty është gypi dhe shkon poshtë andej nga xhamia. Ajo pjesa poshtë nuk ka kurgjë, as gyp, as diçka që pengon. Këtu, përpara shkollën deri pasdite nuk e përfshin as dielli, por bëhet problem kur dalin nxënësit në rrugë me shkue në shtëpi, ose me ardhë mund të ndodhë ndonjë aksident, apo diçka e ngjajshme. Unë propozoj të ndërprehet dhe të vendoset në një vend tjetër sa më shpejtë që është e mundur.

**Sahit Zeqiri** – Ne do ta shqyrtojmë rastin edhe njëherë, të shohim se a mund ta ndryshojmë atë pozicion, apo jo.

**Fidan Ahmeti** – Drejtoria e Arsimit, a ka mundësi me i bë kërkesë policisë nëpër shkolla që me pasë kontrolla më të shpeshta ad-hoc, sepse jemi në dijeni se po ndodhin therrje e deri te vrasjet. Ai është fëmijë, por që merrë vendime të pamatura, të paduhura dhe ne si prindër që jemi e dijme se çfarë sacrificë është me rritë një fëmijë. Ne kur i dërgojmë fëmijët në institucione si shkolla dhe vende publike, mendojmë me pasë siguri më të madhe, prandaj dua që drejtori ti bëjë kërkesë stacionit policor që me pasë kontrolla më të shpeshta, të paktën që këto dukuri të mos jenë nëpër shkollat tona.

**Sahit Zeqiri** – Përgjegjet se me dt.24 janar e kam bërë kërkesën me shkrim zyrtarisht te komandanti i policisë. Në vazhdimësi kemi kontrolla të kohëpaskohshme, që ndoshta nuk janë të mjaftueshme. Ndoshta, kishte me qenë shumë më mirë që së paku ti kemi 2 punëtorë fizik aty, ku është numri më i madh i nxënësve psh në shkollën “Ibrahim Rugova” në 2 shkollat profesionale dhe në Milloshevë.

Kryesuesja e lëshoi mbledhjen për shkaqe shëndetësore dhe anëtarë më i vjetër i Kuvendit, Enver Gashi, vazhdoi me udhëheqjen e mbledhjes.

**Valbonë Beka** – Unë e kam një pyetje për pajisjen e kabineteve, më qe sa ka fillue, deri kur don me iu dhënë një kohë atij furnitori dhe pse po zgjatet aq shumë sepse koha e tij ligjore veç ka mbarue. Tash, çka u bë me ato pajisje.

**Sahit Zeqiri** – Përgjegjet se këtu, pak jemi vonuar me kompaninë, por ka fillue me bë furnizimin dikund rreth 60 %, të mjeteve që duhen të vendosen në punëtori janë të vendosura. Ne i kemi dhënë afat edhe një javë që të pajiset me gjithë ato mjetet, që ju i keni bërë kërkesat. Po ashtu, një pjesë shtesë që është 37,000 euro, që janë dhënë si mjete nga Ministria e Arsimit, ka qe 2 vite e më tepër dhe e kemi bërë edhe atë projekt, që shpresoj se do të kaloj brenda këtyre ditëve. Është e domosdoshme që praktika të kryhet në shkolla.

**Nazlije Shala** – Për shkollën e Mazgitit, klasët nuk kanë ndriçim hiç dhe a ka mundësi dikush me marrë me rregullue këtë çështje, për shkak se tash kur ndërrohet ora edhe nxënësve po iu bjen shumë me humbë.

**Sahit Zeqiri** – Përgjegjet se edhe për këtë jam në dijeni dhe sot do ta dërgoj një punëtor që ta evitoj atë problem. Është një klasë, kërkesa e prindërve më ka ardhë dje dhe sigurisht se sot e kryejmë.

**Albana Shillova Shalaku** – Unë dua ta pyes Kuvendin, ose Komunën se a ka ndonjë plan të afërt që ti pajisë asambleistët me llap top. Edhe më heret e përmendi z.Berisha, a ka ndonjë vijë buxhetore, apo ndonjë plan më të afërt për pajisje me llap top për shkak se ndoshta, do të lehtësohej shfletimi i materialeve dhe trajtimi i tyre si dhe do të ishim më produktiv si asambleistë.

**Lendita Bektoshi** – Sqaron se Kuvendi komunal duhet të ndaj buxhet dhe të marrë vendim në mënyrë që me i sigurue llap topët.

**Ajshe Haliti Pllana** – Unë e kam një kërkesë nga fshati Lajthishtë, që paraprakisht kjo kërkesë i është drejtue edhe Drejtorisë për mbrojtjen e mjedisit dhe Kryetarit, por kanë kërkuar me sjellë edhe në Kuvend. Kjo kërkesë ka të bëjë me një deponi të mbeturinave, që e përfshin rr.”Sabedin Pllana” që është afër lagjes Simnica. Pastaj në fund të kësaj rruge e kemi fshatin Hamidi, të lagjes Kurshumli dhe në fund të rr.”Ajet Dedinca” të lagjes Dedinca. Fshatarët përveç që po kërkojnë pastrimin, ose largimin e kësaj deponie, po kërkojnë edhe me vendos udhëzime për fshatarët për mos hudhje të mbeturinave dhe me i njoftue për gjobat të cilat do të shqiptohen për hudhjen e mbeturinave, pasi që po kanë probleme edhe për mbjelljen e tokave bujqësore dhe po i dëmtojnë shumë tokat bujqësore. Kjo kërkesë është për herën e tretë prej banorëve të fshatit Lajthishtë.

**Sami Ahmeti** – Unë i kam 2 kërkesa dhe kërkesa e parë është se ne e dijmë se mbikqyrjen e kamerave të qytetit e bën policia, por kemi informata se ato nuk janë aktive për një kohë të gjatë. Unë jo vetëm që kam informatë, por kam edhe fakt se vetë veturën time para zyres tuaj, që nuk e di cilës zyre sepse janë 2 paralele ma ka gërvishit dikush, ndërsa policia kanë dhënë përgjegje se nuk funksionojnë kamerat. Unë kam informata se Komuna e ka obligim këtë punë dhe është mirë me ditë që ato me u funksionalizue për të mirën e qytetarëve. Kërkesën e dytë e kam për objektin e qendrës për punë sociale sepse në atë objekt mungojnë pastruesit dhe sigurimi. Ai objekt kundërmon dhe shumica e qytetarëve që shkojnë aty ndjehen shumë keq edhe vetë punëtorët që punojnë dhe dojnë me punue e kanë shumë vështirë ta zhvillojnë aktivitetin e tyre. Sa i përket pastrimit, atyre iu duhet me i pasture vetë zyret e veta dhe për shkak se është zyrë me raste të veçanta, me raste rënda, raste sociale aty, punëtorët nuk e kanë edhe sigurinë e mjaftueshme. Po ashtu, kam informata se disa nga zyrtarët të emëruar politik gjatë gjithë ditës rrijnë pijnë çaj dhe cigare në zyret e këtij objekti. Me qenë pak më korrekt me ndërmarrë masa sepse punëtorët që vërtetë punojnë mbikarkohen me punë edhe të zyrtarëve dhe me punë të menaxhmentit.

**Blerona Shabani Mehmetaj** – Përgjegjet se në objektin e qendrës për punë sociale pastruesi është i caktuar prej NPL “Kastrioti” ndërsa për sigurim do të interesohem. Sa i përket informatave që poqëndrojnë në byfe, do të ua dërgoj një vërejtje përmes drejtorit z.Haki Mjeku, dhe do të ndërmarrë masa që orari i punës të respektohet si orar.

**Enver Gashi** – Edhe unë po ta japë një informim sepse e përdore një shprehje zyrtarë politik dhe unë sa jam në dijeni nuk kemi zyrtarë politikë pë rveq drejtoreshës që e pati fjalën dhe nëse e din se kush është zyrtarë politikë na e shpjegon edhe neve.

**Sami Ahmeti** – Ju e dini më mirë se kush janë ata që janë dërgue prej politikës dhe personat e dërguar prej politikës aty, e shfrytëzojnë autoritetin e vet duke pi cigare dhe kafe gjatë gjithë kohës. Kurdo që doni shkojmë dhe e shihni edhe vetë, e kush janë ata e dini ju vetë.

**Enver Gashi** – I nderuar i dërguar prej politikës, këtë term ku e keni marrë unë nuk e did he përveq kabinetit të Kryetarit dhe Nënkryetarit që janë të caktuar zyrtarët me emër e mbiemër dhe drejtorët që janë 11, unë të tjerë zyrtarë politikë në Komunë nuk di që ka.Pyes, a kanë emër e mbiemër ata.

**Sami Ahmeti** – Po, kanë emër e mbiemër shumica aty që rrijnë veq nëpër byfe janë ata persona që mbështeten prej juve. Ata në emrin e juaj po e shfrytëzojnë autoritetin dhe po thojnë se neve askush nuk mundet asgjë me na bë.

**Enver Gashi** – Ju, nuk jeni i autorizuar me caktue se ata a punojnë, apo nuk punojnë. Ne e kemi drejtoreshën këtu dhe nëse, ke ndonjë vërejtje personale, ose konkrete të një qytetari atëherë mundesh me thënë. Unë e di se zyrtarë politië në Qendrën për Punë Sociale nuk ka dhe ku e keni gjetë ju atë term nuk e di, por jepni emrat nëpër rrjetet sociale se fitoni me këtë.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:52'**


**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal**

  
Vlora Mjekiqi Kabashi





Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.11.11.2022, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

**Mungoi:** Lulzim Preniqi

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetari i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nëkryetar i Komunës, drejtorët komunal, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, përf. e OSBE-së, Daut Mjeku, shef i sektorit për ekonomi, Berat Mehmeti, zyrtar ligjor dhe Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cili, pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## R E N D   D I T E

### 1. Hapja e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor - Planit Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030.

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili me 20 vota për u miratua.

#### **Pika 1 e rendit të ditës**

Kryesuesja kërkoi nga drejtori i DPUKP-së, të prezentoj Draft dokumentin e planifikimit hapësinor-Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit 2022-2030.

**Arben Berisha** – Prezentoj në pika të shkurtëra për çështjen e materialit dhe për çështjen e planit zhvillimor për periudhën 2022-2030, ndërsa do të mbahet edhe një diskutim publik ku iu është dhënë mundësia direkte të tjerëve, për dhënien e vërejtjeve dhe sugjerimeve.

**Kryesuesja** – Hap debatin për Draft dokumentin e cekur më lartë.

**Enver Gashi** – Është një e mirë që po ndodhë në Komunën tonë, që ti japim vizën për diskutim publik një plani zhvillimor hapësinor të Komunës tonë që deri sot ka mungue. Ne si grup më i madh parlamentar e përkrahim, jemi për atë që të kaloj në diskutim publik, do ta japim kontributin edhe atje sepse edhe pse jemi anëtarë të Kuvendit, jemi qytetarë të këtij vendi dhe kur të kthehet në Kuvend, prapë do ta japim kontributin tonë.

**Sami Ahmeti** – Realisht ky është një prej dokumenteve më të rëndësishme të cilin e vlerësojmë dhe shpresojmë që do ti jepë kahje qytetit. Për këtë kohë të shkurtë sa kemi pasë kemi tentue dhe kemi angazhue njerëzit që të merren me këtë dhe me dhënë kontributin tonë. Ne prapë siç tha parafolësi përveç që jemi përfaqësues të qytetarëve jemi edhe qytetarë dhe do të donim që të ishte ky qytet prej më të mirëve të

mundshëm. Sa kemi mund me pa, por e mira është se do të kemi mundësi me i dhënë propozimet tona dhe propozimet tona qysh tash ne kemi fillue me i bë me shkrim dhe shpresojmë me hasë në mirëkuptim. Drejtori e tha se do të jetë një debat publik, ndërsa propozimi i Kryetarit thuhet se do të jetë një muaj ditë në debat të hapur. Ne e mirëkuptojmë këtë dhe shpresojmë se do të delë një dokument shumë i mirë. Te dokumenti kemi hasë që ka jo vetëm ajo vërejtja e drejtorit që ka marrë te Komuna e Glogoc, por ka edhe përzierje edhe emrat e fshatrave janë të shkruara në gjuhën që i kanë pasë administrata paraprake e Serbisë te ne. Psh fshati Palaj, aty shkruan Crkvena Vodica, do të thotë taman qysh shkruhet në gjuhën e atyre. Po ashtu, edhe shumë fshatra tjerë nuk janë sipas kodit qysh shkruhen zyrtarisht në Kosovë, por janë të shkruara paushall. Sido që të jetë për të gjitha këto, ne do të japim kontributin jo në aspektin partiak, por në aspektin qytetar që ky dokument të delë sa më i mirë në mënyrë që qytetarët ta gëzojnë për jetën dhe vendin ku jetojnë. Megjithatë, kjo formë e përshpejtuar me seancë të jashtëzakonshme, mendoj se nuk na ka dhënë hapësirë të mjaftueshme për me shfletue dhe me dhënë kontributin tonë për këtë dokument rreth 400 faqesh, por fakti se do të jetë në debat publik rreth një muaj ne do të provojmë me dhënë kontributin tone dhe jemi për që të hapet si dokument për me dalë në debat publik.

**Kryesuesja** – Ju njoftoj se pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, plani zhvillimor do të jetë për 30 ditë, i hapur në debat publik, ashtu siç e ka potencue edhe Kryetari në Propozim vendimin dhe plani zhvillimor shkon përmes një seance të jashtëzakonshme.

**Ajet Berisha** – Përveç, materialit në mënyrën qysh na keni dërgue, meqë ky material ka shumë rëndësi për Komunën dhe për secilin prej qytetarëve, propozoj që të na vjen i shtypur që ne të kemi mundësi pak më shumë me pa, secilën pjesë të fotografive, secilin propozim për zhvillim të krejtë kësaj. Është mjaft e vështirë dhe unë po tregoj drejtë nuk kam as kompjuter, as llap top, kanë fëmijët që atyre ju duhet, por unë nuk kam. Meqë, nuk kam kërkoj të shtypet materiali nëse, edhe tjerët janë pasi që është material shumë i rëndësishëm kur vjen koha me ditë

çka me thënë, ose nëse kam diçka me propozue. Mirëpo, nuk kisha pasë dëshirë që pa u përpjekë me shqyrtue deri në fund materialin me qenë për, ose kundër. Qëllimi është i përbashkët që ky material me dalë sa më i kompletuar dhe pas 2 viteve, mos me thënë pse nuk e kemi planifikue këtë edhe pse sa e di unë drejtor në një përqindje ky ka mundësi me u revidue. Mirëpo, për me qenë baza e shëndoshë kishte me qenë mirë që këtë material me na shtyp, edhe hartat me ngjyrë që me ditë se nga është planifikue çdo zhvillim.

**Arben Berisha** – Sa i përket emrave të zonave, unë vetë them çdo herë Palaj, por me zonë kadastrale të punuar nga Agjensionit kadastral, i ke ato dhe nuk mundemi me i ndryshue, as me ndërhye në ato sepse është çështje e Agjensionit Kadastral të Kosovës. Kjo është çështje që nuk mundemi as me ngritë sepse nuk mundemi me ndryshue, ju sqaroj me mirëkuptim. Për seancë të jashtëzakonshme e kam marrë aprovimin prej Kryetarit, por mua më është dukë largë me pasë ditën e nesërme duke pasë parasysh çështjen e projektit që është final për Obiliqin, jo vetëm për këto 8 vite, por konditat i jepë edhe për jetëgjatësinë edhe të mëtutjeshme. Ne përmes USB-ive, ju kemi dorëzue materialin sepse emailat zyrtare nuk e kanë përballue vëllimin e materialit. Ne e kemi një kompani që e bën lidhjen e materialit, printimin dhe ajo don një kosto, kështu që nëse, ju e vlerësoni, kryesuesja me administratën munden me rregullue këtë çështje.

**Ajet Berisha** – Materiali është mirë të na vjen i printuar që ne me mund në mënyrë më afatgjate me trajtue dhe me qenë më serioz në trajtimin e tij. Mendoj se e meriton edhe dokumenti dhe ne me pasë.

**Sami Ahmeti** - Për çështjen e emërtimeve, nuk e bëra me qëllim me akuzue dikend të kuptohemi, por këto emërtime në zyrën për dokumente civile janë të shkruara psh Grabofc, që e keni shkruar është Graboc i Epërm, te Sibofci është Siboc, këtu shkruan Sibofc, Crkvena Vodica, Orloviq shkruan që zyrtarisht është Shkabaj. Është mirë me potencue që këto ndryshime të bëhen sipas regjistrit civil sepse këto janë niratue përpara dhe janë aktuale. Unë nuk e bëra absolutisht për kritikë, por qëllimi është me dalë një dokument sa më i mirë edhe me mbrojtë pozicionin tonë sepse kanë luftue njerëzit për këtë punë që me qenë emrat qysh duhet me qenë.

**Arben Berisha** – Ne do të përpiqemi me bë edhe këtë çështje, por komplet kjo është e shkarkuar nga Agjensioni kadastral.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për hapjen e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor – Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030.

**Kryetari** – Sinqerisht ka qenë një punë e jashtëzakonshme, por kur ekipi funksionon mendoj se nuk ka asgjë të paarrtshme. Ne jemi shumë mirënjohës edhe ndaj Ministrisë, që kanë qenë shumë bashkëpunues, të gjitha Drejtoritë si dhe të gjithë qytetarët në debatet publike i kanë dhënë komentet e tyre. Ne jemi munduar ti harmonizojmë të gjitha, por edhe ju në pjesë të ndryshme keni qenë të angazhuar si asambleistë. Mendoj se sot po e jepim një vizë, mundësi shumë më të mirë për qytetarët e Obiliqit për shkak të rrethanave të mëhershme që kanë qenë të kufizuara me planin zhvillimor të kaluar, për shkak të vendimeve të Qeverisë së mëhershme si zonë me interes nacional dhe kjo barierë ka dashtë një angazhim të jashtëzakonshëm për me mund me ardhë deri në këtë pikë. Shpresoj se do të bashkëpunojmë edhe deri në përmbylljen e aktit final, por gjëja më e rëndësishme është që ne ta kemi pëlqimin nga Ministria, për me vazhdue më tutje.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:39'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
**Azize Zeneli**



**Kryesuesja e Kuvendit Komunal**

**Vlora Mjekiqi Kabashi**